



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 2017 /24, Datë 09.10.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 128 të mbajtur më datë 23.09.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore në Universitetin e Prishtinës:

- *Shkencat Mjedisore, Planifikimit dhe Rregullim Territori MSc 120 ECTS*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programit të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Shkencat Mjedisore, Planifikimit dhe Rregullim Territori MSc 120 A</i>	Ferim Gashi Fadil Millaku

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit AKA ka organizuar vizitat në Fakultetin e Shkencave Matematike – Natyrore në Universitetin e Prishtinës me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit: *Badea Ana-Cornelia, Giga Khositashvilli dhe Francisco Silva Costa.*

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportin e vlerësimit për programin, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për këtë program të studimit; Shkencat Mjedisore, Planifikimit dhe Rregullim Teritori MSc 120 vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 29.07.2024, të cilët kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbushë: Plotësisht tre (3), Substancialisht tre (3) kurse Pjesërisht një (1) fusha të standardeve të akreditimit.

Vendimi për mos akreditim është marr për faktin se fusha e standardeve **Infrastruktura dhe pajisjet** ishte e përmbushur vetëm pjesërisht e që sipas Manualit të akreditimit (përditësuar me vendimin Ref.932/22), kjo fushë duhet të përmbushet së paku substancialisht, citojmë: *“Në standardet e vlerësimit për programet e studimit në nivel Bachelor dhe Master, Kapitulli 2, nënkaptulli 2.2 paragrafi 3, i cili i referohet Stafit akademik, dhe paragrafi 7 i cili i referohet Infrastruktura dhe pajisjeve, janë obligativ. Programet e studimit në nivel Bachelor apo Master nuk mund të rekomandohen për akreditim derisa nuk kanë përmbushur në mënyrë substanciale apo të plotë të dy këto fusha të përgjithshme.”*

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen 128 të mbajtur më datë 23.09.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Shkencave Matematike – Natyrore në UP;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

